



BASHKIA
TIRANË

SHTOJCË

MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË
TENDERIT/PREVENTIVIN E PUNIMEVE

Sot më datë 15.01.2019, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Autoriteti Kontraktor, në mbështetje të Nenit 42, pika 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut VII, Neni 62, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si rrjedhojë e paraqitjes së një kërkesë për sqarim nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, vendosi të bëjë një sqarim dhe modifikim për procedurën e prokurimit me objekt: “**Ndërtim i mikrohapësirave publike në Tiranë**”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, vendosi të bëjë një sqarim/modifikim në lidhje me preventivin e punimeve, konkretisht për zërat: “*F.V. hekur betoni periodik*” dhe “*F.V tub për vendosjen e bicikletave me $d=51mm$ dhe $t=3mm$* ”, njësia matëse është kg (kilogram) dhe sasia mbetet e pandryshueshme.

Preventivi i punimeve/ V-Punime të ndryshme:

ISHTE:

Nr.	Manual	Pershkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
5	2.166	<i>F.V. hekur betoni periodik</i>	ton	700		
6	4.3	<i>F.V tub për vendosjen e bicikletave me $d=51mm$ dhe $t=3mm$</i>	ton	600		

BËHET:

Nr.	Manual	Pershkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
5	2.166	<i>F.V. hekur betoni periodik</i>	kg	700		
6	4.3	<i>F.V tub për vendosjen e bicikletave me $d=51mm$ dhe $t=3mm$</i>	kg	600		

Ju lutemi Operatorëve ekonomikë që do të paraqesin ofertat e tyre për këtë procedurë të marrin për bazë këtë sqarim.

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertave me 5 (pesë) ditë kalendarike.

Njësia e Prokurimit njofton të gjithë Operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: **”Ndërtim i mikrohapësirave publike në Tiranë”** është si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 21.01.2019, Ora: 12:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 21.01.2019, Ora: 12:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

